

SHËRBIMET KONTRAKTUESE në EKONOMITË FAMILJARE



SHËRBIMET KONTRAKTUESE NË EKONOMITË FAMILJARE

„Kontrata për shërbime“ është kontratë me të cilën tregtari i jep ose detyrohet t'i jap konsumatorit shërbimin e caktuar, kurse konsumatori për këtë i paguan ose detyrohet t'i paguajë çmimin e caktuar (kompensim), përveç kontratës për shitblerje.

Shërbimet kontraktuese të cilat i shfrytëzojnë konsumatorët mund të jenë shumë të ndryshme! Shërbimet mund të ndahen sipas kriterëve të ndryshme, për shembull, në varësi nga ajo se kush i jep dhe nëse shteti apo vetëqeverisja lokale ka kompetenca të caktuara dhe paraqitet si rregullator, ata ndahen në shërbime publike, komunale dhe private. Në kuadër të shërbimeve publike dhe komunale janë furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë, energji termike, sjelljen e mbeturinave, parkingjet publike, shërbimet e pastrimit të oxhakut, transporti publik etj. Sipas kriterëve tjerë, shërbimet ndahen në shërbime shëndetësore, arsimore, financiare, të telekomunikimit, hotelierisë, turistikë, shërbime për transport të udhëtimeve dhe mallrave, shërbimet intelektuale, shërbimet e avokatit, noterit, të përmbaruesit, shërbime tjerë - të flokëtarisë, kozmetike, shërbimet për argëtim, rekreacion, shërbime të kopshtarisë, ndihmë në ekonominë familjare, grupa e shërbimeve të ndryshme të mjeshtërve, dhe shumë të tjera.

E përbashkët për të gjithë këto është se nga njëra anë kemi konsumator, kurse në anën tjetër mund të kemi person fizik apo juridik që konsiderohet tregtar.

„Konsumatori“ është çdo person fizik që blen produkte apo shfrytëzon shërbime për konsum të drejtëpërdrejtë personal në hapësirat afariste të tregtarit, jashtë nga hapësirat afariste, si dhe me marrëveshje në distancë për qëllime të cilat nuk bëjnë pjesë në kuadër të veprimtarisë të tij tregtare, ekonomike, artizanale apo profesionale

„Tregtari është çdo person fizik apo juridik, i cili pavarësisht nëse është në pronësi private apo publike vepron në kuadër të veprimtarisë të tyre tregtare, ekonomike, artizanale apo profesionale, duke përfshirë edhe çdo person tjetër që vepron në emër të tij apo për llogarinë e tij.

Rrjedhimisht, të gjithë dhënësit e shërbimeve, kur si palë kontraktuese kanë konsumatorin, duhet të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve që rrjedhin nga dispozitat për mbrojtjen e konsumatorëve. Këtu sidomos bëjnë pjesë rregullat për vendosjen e çmimeve dhe rregullat për llogarit-



jen e çmimit, lëshimin e llogarive fiskale apo faturave, dhënien e informatave parakontraktuese, ndalesën e praktikës të pandershme afariste, ndalesën për shfrytëzimin e klauzoleve të pandershme në kontrata, veprimin me kujdes që e kërkon profesioni i tyre për ushtrimin e punëve të caktuara. Për të gjithë këtë mund të gjeni një numër të madh të informatave të dobishme në ueb-faqen e Organizatës të konsumatorëve të Maqedonisë (në tekstin e mëposhtëm OKM).

Broshura para jush ka për qëllim që t'ju tregojë të drejtat dhe detyrimet e caktuara që për ju, si konsumatorë, rrjedhin nga marrëveshjet e konsumatorëve në situata kur shfrytëzohet ndihmë në ekonominë familjare, shërbimet e kopshtarisë dhe të gjithë ato shërbime të cilat shfrytëzohen në ekonominë familjare apo "shërbimet e mjeshtërive" – siç janë ato elektroteknike, hidraulike, zdrukthëtari, tapeta të muri, lloje të ndryshme të shërbimeve të ndërtimit si pllaka, lyerje, parket, zëvendësim të dritareve dhe dyerve, ndërtim me gips-karton, punë tjera të vogla ndërtimore.

Ndoshta edhe ju keni keni patur problem "me mjeshtër": derisa ai është aty, gypi nuk rrjedh dhe sa del nga shtëpia juaj, ka rrjedhur gypi! Keni dhënë shumën e caktuar të parave për mjeshttrin që ai të fillojë të blejë materiale që të rregullojë gardhin, por ai nuk paraqitet më në telefonin që ju kishte dhënë, dhe ju nuk keni vërtetim për atë që keni paguar! Ju kanë lyer, e keni paguar çmimin që ju kanë caktuar dhe për disa ditë ngjyra ka filluar të dalë dhe të hiqet nga muret! Fasada të cilën ua kanë bërë ka filluar të shkërmoqet! Keni thirr urgjentisht mjeshtër që të lirojë guacën e toaletit tuaj dhe u keni paguar për intervenimin urgjent sikur të keni blerë guacë të re dhe zëvendësim të instalimit të tërësishëm të kanalizimit! Gruaja që ju pastron ju ka vjedhur, ju e dini vetëm emrin e saj, kurse numrin e telefonit që ju ka lënë është ndryshuar. Kopshtari ju ka marrë para për të gërmuar fidanet e vjetra dhe mbjelljen e të reja, po ata rriten shumë pak dhe nuk janë të llojit për të cilin jeni marrë vesh, por janë thjeshtë shkopinj që nuk e dini se çfarë do të jenë, por ju keni asgjë me shkrim, dhe nuk keni paguar pak para! Ju kanë prerë gjelbërimin ashtu siç jeni marrë vesh, por të gjithë degët kanë mbetur në oborr dhe kanë bllokuar rrugën, kurse ju keni menduar se çmimi për prerjen përfshin edhe mbledhjen e mbeturinave!

Shumë herë jeni gjetur në situata të ngjajshme. Si të shmangni këto gjendje? Është shumë e vështirë kur në kushtë shërbimeve të paguara mirë të artizanateve, një numër i madh i mjeshtërive dhe artizanatëve kanë ikur jashtë shtetit! Për disa shërbime të mjeshtërive pritët edhe kur nuk është sezoni i renovimeve! Është fakt se ka kërkesë më të madhe për mjeshtër të mirë se sa që është oferta në treg. Kjo imponon edhe çmim më të lartë të lartë të shërbimeve dhe shërbime jociësore! Gjendja e varfërisë ndonjëherë na detyron që të shfrytëzojmë shërbime të cilat ofrohen më lirë, shërbime të miqve dhe fqinjëve, por nuk duhet harruar se i varfëri paguan më shtrenjtë. Në qëllimin për shërbim më të lirë mund të ndodh që të paguajm dy herë sepse pllakat do të bien dhe do të thyhen, parketi do të ndahet ose ngjyra do të dalë...

Secili prej nesh ka patur nevojë për lloje të ndryshme të shërbimeve të tilla. Ndonjëherë na duhet urgjentisht ndonjë mjeshtër: gypi rrjedh dhe kërcënohet të ndodh vërshimi, instalimi mban aromë dhe e kemi fikur energjinë elektrike për shkak të frikës nga zjarri, është bllokuar gypi i kanalizimi në kuzhinë dhe gjendje të ngjajshme. Në raste tjera kemi kohë më të gjatë për të menduar se çfarë shërbimi na nevojitet dhe të krahasojmë çmimet dhe ofertat të cilat na jepen

Para se të thirrni mjeshttrin, duhet të pyesni për këtë:

1. A paguhet veç që vjen dhe diagnostifikon problemin dhe sa kushton kjo? A dallon çmimi në varësi të kohës të ditës në të cilën vjen dhe nga shpejtësia e ardhjes (një orë pas thirrjes apo gjatë natës)?
2. Sa kushton puna, dhe sa kushtojnë materialet?
3. Kush do të sigurojë materialin – ju apo mjeshtri?
4. Krahasoni çmimet e mjeshtrit tuaj me çmimet e mjeshtërtve tjerë!
5. Pyesni nëse në çmim do të hyjë, për shembull, hedhja e mbeturinave, pastrimi pas punës ...
6. Siguroni kohën që të vëzhgoni punën e mjeshtrit! Gjatë kryerjes të punëve, pyesni gjithçka që ju intereson! Insistoni që mjeshtri të konsultohet me ju për të gjithë punët shtesë! Çdo punë shtesë me siguri se kushton para!
7. Më shpesh me mjeshtrit lidhim marrëveshje me gojë! Megjithatë, nëse punët shkojnë në drejtim të gabuar, është e vështirë të dëshmohet se çfarë jeni marrë vesh. Kur është e mundur, marrëveshjen shkruani në letër! Më parë kërkonti nga dhënësi i shërbimi specifikimi të qartë, dhe të kuptueshëm për punët e kërkuara, si dhe çmimin e përgjithshëm si shumë të çmimeve të punëve individuale! Përcaktoni afatin në të cilin duhet të përfundohej puna! Mënyrën e pagesës të çmimit! Dakordoni një dënim kontraktual në rast se puna nuk do të përfundohej në afatin e paraparë!
8. Ku të gjejmë mjeshtër; Më së shpeshti na rekomandon ndonjë i afërm i cili ka patur përvojë pozitive! Ndonjëherë nuk kemi mundësi! Duket se shpalljet në mjetet për informim publik për përzgjedhjen e mjeshtrit janë më të sigurta se fletushkat apo shpalljet e ngjitura në lagjen tuaj apo ata që janë vendosur në kutinë tuaj postare!

Si duhet të silleni:

- Veproni me kujdes si një nikoqir i mirë. Nëse nuk është urgjente, mos shpejtoni në marrjen e vendimeve se cilin do të angazhoni!
- Mos pagoni paraprakisht!
- Siguroni numra telefoni dhe kontakte të mjeshtërtve të dëshmuar.
- Është mirë të dini paraprakisht se kujt t'i drejtoheni në rast të nevojës – nëse kërkonti mjeshtër në momentin kur kërcënoheni nga vërshimi apo ju digjet instalimi, mund të merrni vendim të gabuar. Duhet të keni listën e mjeshtërtve tuaj të dëshmuar!
- Mos kërkonti shërbim nga një mjeshtër i paregjistruar vetëm se prisni se do të ketë ofertë më të favorshme, më të lirë (më shpesh do të dalë se shërbimi është më i shtrenjtë dhe më i keq, dhe nuk ekziston mundësia të gjeni mjeshttrin e paregjistruar për shkak të reklamimit, sepse ata e ndryshojnë telefonin që kanë lënë në materialin reklamues).



- Dakordoni çelës në dorë me një realizues nëse lyeni dhe vendosni fasadë ekonomike, për shembull, apo për punë tjera të ndërlidhura. Nëse janë të përfshirë më shumë realizues, gjithmonë tjetri është përgjegjës për mangësitë e fshehura të cilat do të paraqiten.
- Kur mjeshtri do kërkojë pagesë që është shumë joreale për shërbimin, paratë nuk mund t'i ktheni sepse çmimet për këto shërbime nuk janë të kufizuara me ligj. Prandaj është e nevojshme që për çmimin të merreni vesh me shkrim, para se të filloni të punoni.

Besimin tuaj e meritojnë mjeshtërit të cilët:

- Kanë punëtori të regjistruar;
- Kanë çmimore për shërbimet e tyre;
- Punojnë më gjatë – kanë rekomandime;
- Bëjnë paraprakisht vlerësim të punëve;
- Bëjnë llogari për punët e komplikuar;
- Lëshojnë llogari fiskale për shërbimet e realizuara, si dhe vërtetime për paratë e pranuar me avans;
- Nuk ju pengon që marrëveshja të shkruhet në letër! Apo nëse është investim më i madh të vërtetohet te noteri.

Çfarë duhet të dini! Me marrëveshje nënkuptohen edhe marrëveshjet me gojë edhe me shkrim. Më lehtë dëshmohet kur keni marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dy palët. Por, gjithsesi, nuk do të mund të siguronit marrëveshje me shtrim për çdo „intervenim të mjeshtrit“. Intervenimet më të vogla siguronit me specifikim nga mjeshtri, përshkrimi i punës, të materialeve dhe çmimi. Për intervenimet më të mëdha, marrëveshjen me shkrim me mjeshttrin apo realizuesin e punëve mund ta vërtetojmë në noter, jo vetëm sepse forca për të dëshmuar këtë marrëveshje është më e madhe, por sepse do të detyrojë edhe palën tjetër të mendojë për pasojat nga mosrespektimi i kësaj marrëveshje. Ana e keqe është se gjithsesi do të sillte shpenzime shtesë të avokatit dhe të noterit!

Me kontratën në vepër, realizuesi i punës (sipërmarrësi, realizuesi i punëve) detyrohet që të kryejë punën e caktuar, siç është ndërtimi apo përmirësimi i ndonjë objekti, apo realizimi i ndonjë pune fizike apo intelektuale dhe të ngjajshme, kurse porositësi detyrohet që për këtë të paguajë kompenzim.

Kontrata për dhënien e shërbimeve është në fakt kontratë në vepër. Kontrata në vepër është rregulluar për Ligjin për marrëdhëniet obligative (në tekstin e mëposhtëm LMO).

Dispozitat specifike për mbrojtjen e konsumatorëve janë, siç thamë, në Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve (në tekstin e mëposhtëm LMK)! Rregullat janë të ndryshme për ligjin për shitje nga rregullat për kontratën në vepër. Kontrata me të cilën njëra palë detyrohet që të përgatisë një objekt(send) të caktuar të lëvizshëm nga materiali i tij, kur ekziston dyshimi konsiderohet si kontratë për shitje. Kontrata bëhet kontratë në vepër nëse porositësi është detyruar të japë pjesë thelbësore nga materiali i nevojshëm për ndërtimin e objektit. Në çdo rast, kontrata konsiderohet si kontratë në vepër nëse porositësit kanë patur parasysh sidomos punën e realizuesit të punës.

Pyesni realizuesin e punës sa do të kushtojë ajo që do ta bëjë për ju!

Kur vendosja e çmimeve të shërbimeve bëhet vetëm përmes listës të çmimeve ose tarifave kjo duhet të bëhet në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme.

Sipas Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve: për shërbimet e realizuara për rregullimin dhe mirëmbajtjen e produkteve **vlëra e të cilave është më e madhe se 5.000 denarë**, tregtari duhet t'i parashtrijë konsumatorit llogarinë dhe urdhërin e punës me përshkrimin e punëve, materialin e përdorur apo pjesët për rregullim dhe mirëmbajtje. Urdhëri i punës nënshkruhet nga tregtari dhe konsumatori dhe një shembull nga urdhëri i punës duhet t'i jepet konsumatorit.

Domethënë, nëse rregullimi i pajisjes tuaj elektrike, psh, makina për larjen e enëve (lavastovilja) është më shumë se 5000 denarë, duhet të fitoni llogari dhe urdhër të punës me përshkrimin e punëve, si për shembull, çmimi i ngrohësve që do të ndërrohet dhe ventilatori, çmimi i demontimit, çmimi i montimit, pastrimi i fundërrinës dhe të ngjashme!

Sipas LMK, nëse gjatë rregullimit dhe mirëmbajtjes imponohet nevoja për punë shtesë dhe përfshirjen e pjesëve shtesë për çka nevojitet që të zgjerohet urdhëri i punës, tregtari duhet të marrë pëlqimin paraprak me shkrim nga konsumatori, nëse me zgjerimin e urdhërit të punës çmimi rritet më shumë se 5%. Në rastin e mëparshëm, nëse duhet të zëvendësohen rrëshqitëset dhe filtrat, dhe kjo kushton më shumë se 5% për këtë tregtarin i nevojitet pëlqim me shkrim nga konsumatori. Nëse nuk keni dhënë pëlqim të tillë, nuk duhet të paguani!

Shpesh edhe mjeshtërit kushtëzojnë që për shërbimin e caktuar të paguhet avans për materiale apo pjesë! Në atë rast kërkonti dëshmi për paratë e dhëna dhe zëvendësimin e tyre. LMK e mbron konsumatorin edhe për rastet kur realizuesi i punëve kërkon pagesën avans! Nëse tregtari kërkon apo shprehimisht kushtëzon blerjen e produktit apo dhënien e shërbimit me avans të pjesërishtëm apo të përgjithshëm të njëhershëm apo të llogaritur. Tregtari është i detyruar, nëse afati i dorëzimit të produktit apo shërbimit të dhënë është më i gjatë se një muaj apo nuk mund të dorëzojë produktin apo të realizojë shërbimin në afatin e kontraktuar, konsumatorit t'i llogarisë dhe të kërkojë pagesë sipas normës mesatare të interesit që është e fundit, që llogaritet si mesatare e intervalit të fundit të normave mesatare bankare të fundit, të shpallura nga Banka popullore e Maqedonisë së Veriut, e llogaritur nga dita e pranimit të avansit deri në ditën e dorëzimit të produktit apo realizimit të shërbimit.

Kur jeni marrë vesh që mjeshtri të punojë me materialin e tij, dhe nuk është përcaktuar cilësia, realizuesi i punës është i detyruar që të jap material me cilësi të mesme. Ai i përgjigjet porositësit për cilësinë e materialit të përdorur njësoj si shitësi.

Përsërisim: si konsumator dhe porositës keni të drejtë të bëni mbikëqyrje mbi realizimin e punës dhe të jepni udhëzimet si kjo i përgjigjet natyrës të punës, kurse realizuesi i punës është i detyruar që t'ju mundësojë këtë.

Ai që realizon punën – mjeshtri, kopshtari apo cilido realizues i punës, është i detyruar që t'ju tregojë juve, si porositës, që mungesat e materialit të cilin ja keni dhënë, e të cilat i ka vërejtur apo është dashur që t'i vërejë, përndryshe do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Nëse ju megjithatë këmbëngulni që puna të realizohet me materialin, mangësitë e të cilët u janë treguar nga ana e realizuesit të punës, realizuesi i punës është i detyruar që të veprojë sipas kërkesës tuaj, përveç nëse është e dukshme se materiali nuk është i përshtatshëm për veprën e porositur apo nëse ndërtimi nga materiali i kërkuar mund t'i shkaktojë dëm autoritetit të realizuesit të punës, dhe në atë rast realizuesi i punës mund të shkëpusë kontratën. Realizuesi i punës, gjithashtu, është i detyruar që t'ju paralaj-

jmërojnë ju si porositës, për mangësitë e porosisë tuaj, si dhe në rrethanat tjera të cilat i ka ditur apo është dashur t'i dijë si profesionistë, të cilat mund të jenë të rëndësishme për veprën e porositur apo për realizimin e saj në kohë, përndryshe do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar.

Realizuesi i punës - mjeshtri juaj - është i detyruar që të realizojë punën siç jeni marrë vesh dhe sipas rregullave të punës. Ai është i detyruar që të realizojë punën për kohën e caktuar, dhe nëse kjo nuk është e caktuar, atëherë për kohën që është e arsyeshme për punët e tilla.

Ai nuk do të përgjigjet për vonesën e shkaktuar për shkak të asaj që ju si porositës nuk i keni dorëzuar materialin në kohë, apo për shkak të asaj se keni kërkuar ndryshime, apo se nuk ja keni paguar avansin për të cilin jeni marrë vesh apo për vonesën e shkaktuar për shkak të sjelljes tuaj si porositës.

Duhet gjithsesi të dini se: Nëse gjatë realizimit të punës dëshmohet se realizuesi i punës - mjeshtri, kopshtari apo kushdo tjetër nuk i respekton kushtet e kontratës dhe se nuk punon siç duhet, dhe se puna e realizuar do të ketë mangësi, ju mund ta paralajmëroni për këtë dhe t'i caktoni një afat të duhur që të përshtasë punën e tij me detyrimet e tij. Nëse pas kalimit të këtij afati, realizuesi i punës nuk vepron sipas kërkesave tuaja, ju mund të shkëpusni marrëveshjen me gojë dhe me shkrim dhe të kërkonit kompensim të dëmit përmes gjykatës, nëse është shkaktuar dëm.

Nëse përgatisni dasëm, ditëlindje, shënim të ndonjë ngjarjeje me datë fikse apo nëse afati është përbërës thelbësor i kontratës, kurse realizuesi i punës është në vonesë të tillë në aspekt të fillimit apo përfundimit të punës dhe është e dukshme se nuk do ta përfundojë në kohë, mund të shkëpusni kontratën dhe të kërkonit kompensim të dëmit. Këtë të drejtë e keni edhe atëherë kur afati nuk është përbërës thelbësor i kontratës, nëse për shkak të vonesës të tillë, ju, si porositës, është e dukshme se nuk do të kishit interes për përbushjen e kontratës.

A duhet që mjeshtri realizues i ndonjë ndërhyrjeje ndërtimore të përfundojë punën personalisht? Kur merreni vesh me ndonjë mjeshtër, duhet të prisni se nëse nga kontrata apo natyra e punës nuk del diçka tjetër,

realizuesi i punës nuk është i detyruar që punën ta realizojë personalisht. Realizuesi i punës edhe më tutje përgjigjet para jush për realizimin e punës edhe kur punën nuk do ta realizojë personalisht. Realizuesi i punës përgjigjet për personat të cilët me urdhër të tij kanë punuar në punën që ka ndër-marrë dhe ta realizojë si ta ketë realizuar vetë.

Kujt jeni i detyruar t'i paguani? Për pagesën e kërkesave të tyre nga realizuesi i punës, bashkëpunëtorët e tij mund të drejtohen drejtpërdrejtë deri te ju dhe nga ju të kërkojnë që t'i paguani ato kërkesat mbi barrën e shumës që në atë moment ju duhet t'ia paguani realizuesit të punës, nëse pranohen ato kërkesa.

Gjithmonë kontrolloni punën e përfunduar!

Ju jeni të detyruar që të kontrolloni punën e detyruar pasi që ajo sipas rrjedhës të rregullt të punës është e mundur edhe për mangësitë e gjetura dhe të njoftoni realizuesin e punës pa shtyrje. Nëse



në thirrjen e realizuesit të punës që të kontrollojë dhe pranoni punën e realizuar nuk e bëni këtë pa shkak të arsyeshëm do të konsiderohet se puna është pranuar. Kjo është e rëndësishme sepse pas kontrollit dhe pranimi të punës të kryer, realizuesi i punës më nuk përgjigjet për mangësitë që do të mund të vërehen me kontroll të thjeshtë, përveç nëse ka ditur për ato, dhe nuk u ka treguar për ato.

Çfarë do të ndodh me mangësitë e fshehura? Mangësitë që do i vëreni më vonë!

Nëse më vonë tregohet ndonjë mangësi që nuk mund të zbulohet me kontroll të thjeshtë, ju si porositiës megjithatë mund të thirrni në të me kusht që për të të njoftoni realizuesin e punës sa më shpejtë që është e mundur, dhe më së voni në afat prej një muaji prej zbulimit të tij. **Me kalimin e dy viteve nga pranimi i punës të realizuesit, porositiësi nuk mund të thirret më në mangësitë.**

Kujdes: Porositiësi që në kohë ka njoftuar realizuesin e punës për mangësitë e punës të realizuar, nuk mundet që punën e tij ta realizojë me rrugë gjyqësore pas kalimit të një viti nga njoftimi i bërë. Megjithatë, gjithsesi, nëse nuk e paguani çmimin e shërbimit në tërësi, mund të reagoni edhe pas këtij afati. Porositiësi mundet, nëse për mangësitë në kohë ka njoftuar realizuesin e punës, me kundërshtim kundër kërkesës të realizuesit të punës për pagesën e kompenzimeve të shprehë të drejtën e tij të zvogëlimit të kompenzimeve dhe kompenzimit të dëmit edhe pas një viti.

Çfarë ndodh me mangësitë për të cilat nuk keni njoftuar në kohë? Porositiësi që në mënyrë të rregullt njofton realizuesin e punës se puna e realizuar ka ndonjë mangësi, mund të kërkojë nga ai të largojë mangësinë dhe për të t'i caktojë afatin e duhur. Nëse ka ndodhur ndonjë dëm, keni të drejtë edhe në kompenzim të dëmit. Nëse largimi i mangësive kërkon shpenzime të tepruara, realizuesi i punës mund të refuzojë të realizojë, por, në atë rast, porositiësi, sipas zgjedhjes të tij i takon e drejta e zvogëlimit të kompenzimit apo shkëputjes të kontratës, si dhe e drejta në kompenzim të dëmit.

Kur puna e realizuar ka mangësi të tillë që e bën të papërdorshme apo është realizuar në kundërshtim me kushtet shprehimore të kontratës, porositiësi mundet, pa kërkuar paraprakisht largimin e mangësisë, të shkëpusë kontratën dhe të kërkojë kompenzim të dëmit.

Në rastet tjera detyroheni që nëse jeni të zemëruar për shkak se puna e realizuar ka mangësi dhe është e papërdorshme, respektivisht kur puna është realizuar në kundërshtim me kushtet shprehimore të kontratës, **t'i mundësoni realizuesit të punës të largojë mangësinë.** Ndërkohë, mundeni që realizuesit të punës **t'i përcaktoni një orar të duhur për largimin e mangësisë.** Nëse realizuesi i punës nuk e largon mangësinë deri në përfundimin e atij afati, mundeni, sipas përzgjedhjes personale të realizoni heqjen e mangësisë në llogari të realizuesit të punës, apo të zvogëloni mangësinë apo të shkëputni kontratën.

Kur bëhet fjalë për mangësi jo domethënëse, nuk mund të shfrytëzoni të drejtën e shkëputjes të kontratës. Në çdo rast e keni edhe të drejtën për kompenzimin të dëmit.

Nëse përcaktoheni për **zvogëlimin e kompenzimit**, kjo bëhet në proporcion ndërmjet vlerës të punës të realizuar pa kompenzim në kohën e lidhjes të kontratës dhe vlerës që do ta kishte në atë kohë puna e realizuar me kompenzim.

Detyrimet tuaja si porositës janë:

- Të pranoni punën e realizuar sipas dispozitave të kontratës dhe rregullave të punës;
- Të përcaktoni kompensimin me kontratë, nëse nuk është përcaktuar me tarifë të detyrueshme apo me ndonjë akt tjetër të detyrueshëm;
- Nëse kompensimi nuk është përcaktuar, do ta përcaktojë gjykata sipas vlerës të punës, sipas kohës normale të nevojshme për atë punë, si dhe sipas kompensimit të zakonshëm për atë lloj të punës.

Mbani mend: nuk jeni të detyruar që të paguani kompensimin para se të kontrolloni dhe ta miratoni punën e kryer, kini kujdes që të mos jeni marrë vesh për diçka tjetër!

Kërkoni llogari me garancë shprehimore ose të paktën formulë jo më shumë se ajo vlerë! Nëse për kompensimin jeni marrë vesh në bazë të llogarisë me garancë të shprehur nga realizuesi i punës për saktësinë e saj, ai nuk mund të kërkojë rritjen e kompensimit edhe nëse në punë ka investuar më shumë punë dhe nëse realizimi i punës ka kërkuar më shumë shpenzime se sa që është paraparë. Me këtë nuk përjashtohet zbatimi i rregullave për shkëputjen dhe ndryshimin e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave. Nëse për kompensimin jeni marrë vesh në bazë të llogarisë pa garancë të shprehur nga realizuesi i punës për saktësinë e saj, dhe gjatë punës tejkalimi i llogaritjes është dëshmuar si i pashmangshëm, realizuesi i punës duhet që pa shtyrje të informojë për këtë porositësin, përndryshe e humb çdo kërkesë për shkak të rritjes të shpenzimeve.

Duhet të dini edhe diçka!

Derisa nuk është përfunduar puna e porositur, mund të shkëpusni kontratën – me gojë, me shkrim, të vërtetuar në noter, sa herë që dëshironi! Por, në atë rast do të detyroheni që realizuesit të punës t'i paguani kompensimin e kontraktuar, të zvogëluar për vlerën e shpenzimeve që ai nuk i ka bërë, dhe të cilat është dashur t'i bëjë nëse nuk do të shkëputej kontrata, si dhe për vlerën e përfitimit që ka realizuar në anën tjetër apo që ka shmangur qëllimisht që ta realizojë.

Në internet keni informata për krahasim të shërbimeve dhe çmimeve dhe kontakteve për shërbimet për ekonomitë familjare:

https://4connect.eu/category.html?category_id=1

<https://najdimajstor.com/>

<http://www.majstor.mk/>

<https://usluga.mk/main/search>

Per këshilla shtesë në lidhje me të drejtat Tuaja si konsumatorë, mund të drejtoheni tek Organizata konsumatorëve të Maqedonisë- OKM- Shkup, tel 02/3179 592

ose nëpërmjet ueb-faques <https://opm.org.mk/>

E-mail: sovetuvanja@opm.org.mk